



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINE
OPŠTINA KLINE



www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS
01. Nr. 06- 668
KLINË, 24.1.2017

PROCESVERBAL

NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KK-së, MBATJUR, MË 24.1.2017, NË
ORËN 14:00, NË SALLËN E KK

Në mbledhje prezantuan: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, Kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, nënkyetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e Kuvendit, drejtorët e drejtorive, Zyra ligjore, Komandanti i Policisë, Rexhë Berisha, përfaq. të KFOR-it, përfaq. të OSBE-së, Zyra komunale për Integrime Europiane, OJQ “Koha”, Zira për Informim etj.

Seancën e udhëhoqi kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroj mirëseardhje në këtë seancë të KK- së.

“Duke u mbështetur në nenin 44 dhe të nenit 44.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.. 03/L-040, neni 6 të Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës së Klinës, me kërkesën e Kryetarit të Komunës, 01 Nr.06-178/2017 të dt. 17.01.2017, për caktimin dhe mbajtjen e seancës së Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës për dt. 24.01.2017, me fillim në orën 14:00. Është një letër që Kryetari na ka dërguar për një seancë të jashtëzakonshme dhe unë si Kryesues i Kuvendit ju kam përgjigjur ftesës së Kryetarit që ne do të thërrasim një seancë të jashtëzakonshme, bazuar në ligj dhe bazuar në rregullore dhe për më tepër për natyrën e kërkesës për seancë të jashtëzakonshme fjalën e bart te kryetari i Komunës, z. Sokol Bashota”, tha Kryesuesi Ibishi.

Sokol Bashota, foli rreth çështjeve. “ Fillimisht me lejoni që pa dashur të hyj në arsyeshmërinë e plotë, më në detale, të qëllimit për të cilin jemi mbledhur sot, unë fillimisht dëshiroj që ju asamblistëve t’ju kërkoj falje që e kam thirrur këtë seancë të jashtëzakonshme me qëllimin më të mirë për të arritur disa afate të cilat janë të nevojshme dhe të domosdoshme për të përfituar një projekt, i cili është mjaft i rëndësishëm për qytetarët. Ju e dini se kjo është seanca e parë e jashtëzakonshme që thërras që dhjetë vite sa jemi së bashku në këtë qeverisje. Kemi thirrur

seanca të tjera të jashtëzakonshme që kanë qenë të dakorduar për një qëllim tjetër, mirëpo kjo është seanca e parë për të cilën, realisht më vjen keq që ndoshta ju kemi ndarë nga obligimet e juaja që i keni, por kisha kërkuar nga gjithë ju që të keni mirëkuptim për këtë arsy. Ju e dini se Komuna e Klinës ka garuar për një mjedis të pastër me GIZ-in gjerman, është një projekt i cili është duke u mbështetur kryesisht nga GIZ-i gjerman. Dhe në këtë projekt GIZ-i ka punuar dy plane, që është Plani për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planin për Integritetin, të cilat plane komunat tjera, nuk janë në këtë pilot-projekt, janë të obliguar dhe detyrimisht kanë për t'i bërë këto dy plane për arsy se për t'i arritur disa standarde. Këto kapin vlerën diku afersisht rrëth 60 mijë euro të cilat në një mënyrë nga GIZ-i gjerman këto veç i kemi të përfunduara dhe jemi përfitues. Lufta po bëhet për menaxhimin e mbeturinave është një projekt, që tash gati-gati jemi kampion sa i përket regjionit të Pejës për grumbullimin e mbeturinave, për shtrirjen gjografike të Kompanisë së Ambientit për t'u marrë me trajtimin e këtyre mbeturinave, edhe rritjen e shkallës së inkasimit. Domethënë në regjionin e Pejës jemi më të mirët sa i përket kësaj fushe. E potencova këtë me qëllimin më të mundshëm se jemi shumë afér përfitimit të një grandi nga GIZ-i gjerman për 150 mijë euro, këta që janë marrë me këtë çështje, tregojnë që 150 mijë euro në qoftë arritën këto afate, Komuna veç i përfiton, por jemi duke bërë gara për të përfituar edhe një projekt tjetër që është diku rrëth 350 mijë euro, të cilat do të dedikohen për regjionin e Pejës. Realisht e kishim lënë në një seancë të rregullt, nuk dua të merrem se sa kemi arritur për t'i bindur KPF-në për ta prurë në seancë të rregullt, ndoshta ka qenë një defekt, por pavarësisht prej saj, edhe një herë po kërkoj falje që po shfrytëzoj këtë të drejtë si kryetar i Komunës për ta thirrur seancën e jashtëzakonshme, me qëllimin më të mirë për t'i arritur këto afate dhe të mos lëmë për ta humbur këtë mbështetje nga GIZ-i gjerman që është në shërbim dhe interes të të gjithë qytetarëve. Vonesat nuk janë bërë si rezultat e punës së ekzekutivit, këtë dua t'ju sqaroj të gjithë asamblistëve, unë kam pasur vërejtje edhe prej asamblistëve të radhëve të PDK-së, por seanca nuk thirret si rezultat i neglizhencës së ekzekutivit, por thjeshtë që GIZ-i me një kompani kontraktuese nuk ka arritur për t'i plotësuar afatet që neve për të na ardhur me kohë dhe për të zënë KPF-në edhe asamblenë e rregullt. Prandaj vetëm kemi për të vënë në debat me publikun, janë një muaj afat, ku mund t'i japim gjithsecili vërejtjet dhe sugjerimet tona rrëth këtij projekti dhe kemi për ta prurë këtu në këtë AK edhe do të miratohet ky projekt, afati i fundit është diku 28 shkurt 2017, që si Komunë duhet për ta zënë. Edhe një herë, faleminderit që ju keni përgjigjur kësaj fteze me mirëkuptimin që ju kemi thirrur në këtë seancë të jashtëzakonshme, mendoj që keni për ta ndarë gjithsecili opinionin tuaj në interes dhe shërbim të qytetarëve të Komunës së Klinës, për arsy se Komuna e Klinës në këtë rast nëse e arrit këto afate është përfituese e këtij projekt që është shumë i rëndësishëm për neve”, ka konstatuar kryetari Bashota.

Kryesuesi Ibishi, sqaroi anëtarët se çfarë është takimi i jashtëzakonshëm, që është i bazuar në Rregulloren për Punë të Kuvendit.

Haxhi Ibishi: “Unë mendoj që ajo përplasje e vogël ka krijuar një hapësirë për të mbërrit kohën, mendoj që jemi në të njëjtat valë të dy palët. “Neni 6, takimi i jashtëzakonshëm i KK thirret me kërkesën e bërë me shkrim nga më së paku 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit,

apo kërkesës së Kryetarit. Neni 44 i LVL, e drejta për të thirrur një takim të jashtëzakonshëm gjithashu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar. Pikat e caktuara për rendin e ditës për mbledhje të jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes. Takimi i jashtëzakonshëm nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk janë njoftuar me shkrim siç kérkon rregullorja e punës së paku 3 ditë punë. Mendoj që të gjitha procedurat drejt kësaj seance janë përfillur në konsultim me Ekzekutivin, edhe me Zyrën Ligjore. Mua nuk më mbetet tjetër përpos që t'ju njoftoj për procedim. Domethënë, ju e keni marrë rendin e ditës me kohë dhe ju kisha lultur të deklarohet kush është për rendin e ditës ashtu qysh e keni marrë”, ka shtuar kryesuesi Ibishi.

Me vota unanim (26) u miratua ky

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Marrja e Vendimit për vënie në diskutim publik të Projekt-rregullores komunale për Menaxhimin e Mbeturinave,
3. Marrja e Vendimi për vënie në diskutim publik të Draft – planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2017-2021,
4. Marrja e Vendimit për vënie në diskutim publik të Draft-planit të Integritetit 2017-2019.

Fadil Gashi, tha se e para gabuam ne që miratuam se ju vetë po thoni se rendi i ditës caktohet veç me atë që e kérkon se seancën dhe mos e bëni aq të madhe, sepse është normale për të pasur seanca të jashtëzakonshme, ai ligjvënësi nuk e ka bërë pahiri këtë punë, edhe kjo pse e ka emrin “e jashtëzakonshme”, është rregull, sepse nxjerrën vendime, nxjerrën qëndrime, edhe është legale, është legitime. Për këtë po më duket që shumë jeni duke i dhënë rëndësi, edhe kryetari, na kerkoi shumë falje, falje nuk ka nevojë, sepse ne kur jemi zgjedhur e kemi ditur se vijmë edhe në këso situata, edhe është krejt normale për ta mbajtur një seancë të jashtëzakonshme, dy, varësisht prej çështjeve. Tjetër çfarë desha të them, po marr pak të drejtë, sepse kemi debatuar bukur shumë edhe në KPF, edhe po dua edhe një herë për ta sqaruar para jush dhe para kryetarit, që s'kanë qenë, edhe kryetari, edhe nënkyetari, edhe komplet ekzekutivi nganjëherë, nuk po them në muaj, nganjëherë kur të kanë kohë le të vinë dhe të shikojnë qysh punon KPF dhe sa e respektojnë drejtorët KPF-në. Le të vinë dhe të këqyrin cilët drejtorë prezantojnë në seanca, pa dashur injoruar asnjë zyrtar prej portierit që punon në Komunën e Klinës e deri të Zyra e Kryetarit. Po ju e dini që neve na raportojnë në KPF drejtorët, nuk mundeni për të na dërguar gjithkënd këtu, sepse ka përcaktuar ligji. Mos ma merrni për injorim. Edhe ne kemi njëfarë uni tonë, uni ligjor, nuk është personal ky, por uni që na ka dhënë ligji dhe atë ditë nuk ka mundur askush të na sqarojë, sepse ne nuk patëm as material, edhe aty na u tha herë një pikë e rendit të ditës, herë na dalshin tri pika të rendit të ditës, nuk është bash e kthjellë qysh është sot. As vetë nuk kemi ditur atë ditë se çka votojmë. Prandaj po them unë edhe sot e përkrahi, nuk ka qenë që

se kam përkrahur edhe atë ditë, por kemi kërkuar sqarime, edhe vetëm të mos votojmë përmendsh. Krejt këtë desha ta sqaroj në këtë mënyrë”, është shprehur anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, sqaroi se kur është seancë e jashtëzakonshme është e precizuar qartë.

Tunë Dedaj, tha se kryetari e dha shpjegimin pse na ka ftuar, këto fjalë desha t'i them dhe i them prapë. “Unë i kisha zënë shumë për të madhe sikur të mos na kishte thirrur dhe shkaku i një seance sikur të na kishte mbetur pa fituar atë grand, do të thotë është mirë, jo vetëm për këtë, por nëse ka edhe ndonjë mundësi tjetër të gjejë ndonjë projekt për të bërë kanalizimin e ujërave të zeza në Komunën e Klinës le të na thirr për çdo muaj nga një seancë të jashtëzakonshme, pa asnjë problem vijmë”, tha anëtari Dedaj.

Sokol Bashota, tha se nuk dua të sqaroj shumim, vetëm desha ta them: Përderisa është e jashtëzakonshme është logjike për kërkim falje, se është më tepër për kulturë, realisht është e zakonshme. “:Jam shumë i vetëdijshëm me rregullore thotë nuk ndryshohen pikat e rendit të ditës nga asamblistët dhe se pikat e rendit të ditës duhet të votohen nga asambleja dhe është ligjore kjo. Edhe në herë dua ta sqaroj për Fadilin edhe le ta dinë mirë edhe asamblistët, edhe përfaqësuesit të KPF-së, drejtorët e mi kanë urdhër, asnjë vendim urgjent nuk ka për të futur në qoftë se është rezultat i neglizhencës së tyre. Seancat e jashtëzakonshme që tha Tuna për nevojat të cilat janë emergjente është përfituese Komuna fare nuk kam për të hezituar, duke i thirrur edhe shefat e grupeve parlamentare për të sqaruar se është interesi i qytetarëve të Komunës së Klinës, ndoshta-ndoshta për të thirrur edhe seancë në tri-katër herë në muaj po që se është nevoja, se e di që asnjë nga ju nuk është i interesuar të punojë në dëm të qytetarëve. Prandaj këtë ta keni parasysh, drejtorët e drejtorive gjegjëse për natyrën e punës së vet, kanë për të qenë prezent dhe në momentin që ata nuk janë prezent vetë personalisht për ta çuar një çështje, kisha bërë thirrje për të mos e votuar kurrë. Drejtorët e kanë marrë mesazhin e qartë nga unë. Edhe materiali është pak voluminoz, mirëpo nuk kemi çfarë t'i bëjmë”, tha kryetari Bashota.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi se ka një arsyetim të mungesave të anëtarës Violeta Zefi, të tjera mungesa nuk ka.

Marrja e Vendimit për vënie në diskutim publik të Projekt-rregullores komunale për Menaxhimin e Mbeturinave.

Kryesuesi Ibishi foli rrëth pikës së rendit të ditës. Fjalën e barti te drejtori i DSHPE, z. **Gjokë Lleshaj**.

Gjokë Lleshaj, drejtor i Drejtorisë për SHPE, sqaroi Projekt-rregulloren komunale për Menaxhimin e Mbeturinave.

“Ndoshta shumë çështje i sqaroi kryetari, mirëpo unë dëshiroj të sqaroj një herë para jush edhe anëtarëve të KPF-së për mosprezencën time, që nuk e kam lënë për asnjë punë, mirëpo e kam

vlerësuar si një punë shumë të lehtë dhe se atë ditë kam qenë i zënë me mirëmbajtjen e rrugëve që nuk kam qenë, përndryshe kisha ardhur. Këtë ishte fjala për këto, ne jemi në garë me GEZ-in që ka më shumë se një vit. Me 2015 kemi qenë po ashtu në një garë për menaxhim të mbeturinave dhe ndriçim publik, si komunë kemi zënë vendin e parë dhe kemi marrë dy projekte që asnjë komunë nuk ka marrë dy projekte edhe atë e keni pasur votuar dhe miratuar ju dhe me ndihmën e juaj ne i kemi pasur marrë dy projekte, ka qenë, menaxhimi i mbeturinave, që i kemi marrë kontejnerët edhe kemi marrë ndriçimin publik, që kanë qenë me mbështetjen e juaj dhe punën tonë të vazhdueshme. Vërtet nuk ka pasur hezitim apo ndalje të dokumenteve ose të procedimit në KPF. Vërtet ditën që ne na ka ardhur materiali nga GIZ-i atë ditë kemi proceduar derisa kemi shtypur materialin vetë në pamundësi për ta shtypur materialin Zyra e Kuvendit, kemi marrë masa edhe me Dardanin edhe i kemi shpërndarë për të siguruar materialin se ka qenë material shumë i madh. Kështu që në këtë kohë, ka një vit që jemi me këtë projekt dhe besoj se ne do ta arrijmë. Këtu nuk e kam paraparë shumë se ka qenë shumë i rëndësishëm sepse ka qenë vetëm të vihet në diskutim publik, pastaj kemi seancën e fundit që na mundësohet t'i shtjellojmë dhe t'i themi të gjitha këto. Unë besoj që planin e keni përpëra, edhe rregulloren, kështu që nuk e shoh diçka deri në miratimin, se dita e fundit është ashtu siç e tha kryetari, 28 shkurti duhet për të qenë i miratuar, përndryshe na eliminojnë. Na eliminojnë prej gare, sepse pa i diskutuar këto, pa i dorëzuar ditën e fundit, më 28 shkurt, do të na eliminojnë prej gare. Kështu që, ju falënderoj po ashtu edhe për gatishmérinë që keni ardhur ju sot, edhe gatishmérinë e kryetarit dhe të gjithëve që kanë qenë të gatshëm në mënyrë që mos ta humbim këtë donacion. Unë besoj se për pikat e rëndësishme veç e veç mund edhe tash t'i diskutojmë, por besoj që mund ta lëmë edhe në mbledhjen e fundit që ta kemi në miratim, ku sigurisht do të bëjmë kërkësë që ét vinë edhe hartuesit të këtij plani për ndonjë detal se ndoshta ne nuk mund të jemi ekspertë të kësaj lëmie, prandaj ta kemi ftuar edhe hartuesin e këtij plani, që besoj më 28 shkurt do të jetë edhe ai prezent edhe na i sqaron të gjitha gjerat. Megjithëse nuk ka diçka të paqartë. Kërkoi nga ju që ta votoni dhe të procedojet më tutje që në mbledhjen e fundit të datës 28 shkurt të miratohet”, ka sqaruar drejtori Lleshaj.

Haxhi Ibishi, kërkoi nga shefat e grupeve parlamentare që të deklarohen. “Meqenëse materiali është për t'u vënë në diskutim publik, ka kohë që të diskutohet, ka mundësi të futen propozime të reja”, tha kryesuesi.

Halil Desku (PDK), tha se unë do t'i përbahem asaj vijës që prezanton këtu edhe kryetari, nuk do të flasim për të kaluarën, nuk do të flasim për KPF-në, sot jemi në një situatë të re. “Angazhimi im ka qenë atë ditë dhe kemi vendosur ashtu siç edhe u sqarua këtu, që të procedojet atë ditë. Unë kam mendimin e njëjtë, kam diskutuar disa herë dhe i kisha thënë procesmbajtësit ta mban në gjendje të rregullt atë proces ashtu qysh kemi folur dhe sot pa asnjë hezitim t'i miratojmë këto dokumente. Mua më vjen shumë mirë që u arrit më në fund për të ardhur në një seancë të jashtëzakonshme të miratohet dhe të procedojet dhe të përfitojnë qytetarët e komunës së Klinës. Këtu nuk ka përfitimi politike, por ka përfitimi të qytetarëve të

Komunës së Klinës. Unë edhe grapi im i PDK-së jemi të gatshëm për t'i votuar të tri pikat veç e veç”, shtoi prof. Desku.

Arben Limani (LDK), tha se edhe ne si GP mbështesim marrjen e vendimit për vënien në diskutim publik të kësaj projekt-rregulloreje.

Tunë Dedaj (AAK), tha se edhe ne si AAK i japim mbështetje kësaj rregulloreje.

Ndue Shabanaj (IPK), tha se edhe unë e mbështes plotësisht dhe besoj që kemi për të pasur mundësi për të dhënë kontributin tonë edhe në detaile kur do të shqyrtohet kjo në seancën e rregullt pas diskutimit publik dhe të gjitha, domethënë ekziston hapësirë e mjaftueshme kohore kur ne mund ta japim kontributin. “Është mirë për ta plotësuar krejt këtë infrastrukturë të domosdoshme ligjore për menaxhim të mbeturinave si parakusht për një ambient të pasur. Do të thotë janë të gjitha këto procedura që shkojnë me radhë dhe besoj se e ka vlerën dhe meriton për ta përkrahur dhe jam plotësish në përkrahje të saj”, ka theksuar prof. Shabanaj.

Skënder Merutri (3 Plus), tha se në emër të grupit e përkrahim rendin e ditës dhe e votojmë. “Thjesht, shqetësimi im ose dilema ime është sa do të jetë ekzekutivi përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje, se është një rregullore e mirë, e kam lexuar 2-3 herë, është një rregullore e punuar mirë, por dilema ime do të jetë në vazhdimësi sa do të jetë ekzekutivi i angazhuar në zbatimin e asaj rregulloreje për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Klinës, a i ka të gjitha kapacitetet atë rregullore për t'u zbatuar në atë mënyrë qysh është e shkruar, përndryshe do e votoj”, ka konstatuar anëtari Merturi.

Bozhidar Sharkoviq (Lista Serbe), tha se edhe unë e mbështes këtë projekt-rregullore, se do të kemi mjaft kohë për të shqyrtuar dhe diskutuar.

Kryesuesi vuri në miratim marrjen e vendimit për vënien në diskutim publik të projekt-rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave.

Me vota unanime (26), u miratuar Vendimi për vënien në diskutim publik të Projekt-rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave.

Pika e tretë: Marrja e Vendimi për vënien në diskutim publik të Draft – planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2017-2021.

Kryesuesi foli rrëth Draft-planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2017-2021.

Kryesuesi hapi diskutimin. Nuk pati diskutimi.

Kryesuesi tha se po deklarohemi si Kuvend, nuk po hymë me GP. Vuri në miratim vendimin për vënien në diskutim publik të Draft-planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2017-2021.

Me vota unanime (26) u miratua Draft-plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2017-2021.

Pika e katërt: Marrja e Vendimit për vënien në diskutim publik të Draft-planit të Integritetit 2017-2019.

Kryesuesi foli rrreth pikës në rend të ditës. Hapi diskutimin. Nuk pati diskutime. Kryesuesi e vuri në rend të ditës Vendimin për vënien në diskutim publik të Draft-planit të Integritetit 2017-2019.

Me vota unanime (26) u miratua vendimi për vënien në diskutim publik të Draft-planit të Integritetit 2017-2019.

Sokol Bashota, falënderoi anëtarët e KK për kontributin e dhënë dhe mbështetjen që ata i dhanë këtyre projekteve.

Tunë Dedaj, kërkoi që anëtarëve të KK t'u sillet procesverbali i mbledhjeve të KPF-së.

Kryesuesi Ibishi, sqaroi se procesverbali i KPF-së është i KPF-së.

Kryesuesi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë. Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 14:35 minuta.

Procesverbalı,
Mikel GOJANI

mikel.gojani

